



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE SH.A

---

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

#### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

#### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

#### OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtje riparim shërbim për mjetet e transportit”

#### KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50000000-5 - Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi

#### VLERA E FONDIT LIMIT:

**11,190,000** (njembedhete milion e njeqind e nentedhete mije) Lekë Pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesë Licencë (të vlefshme), kategoria VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, për vendin ku ushtron aktivitetin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2023, 2024, 2025 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, paraqitja e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

**2.2.2** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë informacion mbi xhiron vjetore për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar. Përcaktimi i kërkesës për xhiron vjetore është bërë në përpjesëtim me vlerën e fondit limit dhe natyrën e kontratës, me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë disponojnë kapacitet të mjaftueshëm financiar për realizimin e kontratës. Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të cilat përcaktojnë detyrimin e tatimpaguesve për deklarimin e të ardhurave dhe dokumentimin e aktivitetit ekonomik. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të sigurohet që operatorët ekonomikë kanë stabilitet financiar dhe aftësi për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata, duke garantuar realizimin e saj me sukses.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve përkatësisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente;
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente;
- ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten:

Çertifikatat përkatëse, objekti i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

AK rezervon mundësinë e verifikimit të certifikatave pranë DPA në Ministrinë e Financave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

- **Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e eficiencës së shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.
- **Standarti 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”** – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë shërbimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, procese gjatë të cilave përdoren produkte që mund të jenë të dëmshme për mjedisin, si vajrat dhe kimikatet. Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.
- **Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga makineritë që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, djegie nga substanca të nxehta, lëndime nga kontaktet me kimikate toksike apo ndotëse, madje edhe ndotje akustike.

2.4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht **7 (shtatë) punonjës** sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik.
- b) 1 (një) motorrist
- c) 1 (një) xhenerik
- d) 1 (një) saldator
- e) 1 (një) elektroauto
- f) 1 (një) mekanik
- g) 1 (një) gomist

Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomë perkatëse si dhe kontratën e punës (të vlefshme) ku te jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik.

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e, f, g më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat individuale të punës.
- Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

OE duhet të paraqesi Listëpagesat për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të mjeteve motorrike, është e nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si motorist, xhenerik, saldator, elektroauto, saldator, xhenerik me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kane nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri

**2.4.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) Pajisje ura ngritese për automjetet
- b) Gropë riparimi sipas standardeve teknike
- c) Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit
- d) Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet
- e) Bangoprovë për testim dhe pastrim injektorësh
- f) Bangoprovë për motorrino dhe dinamo
- g) Bangoprovë për sistemet hidraulike
- h) pajisje per saldim
- i) Pajisje për servis dhe mirëmbajtje (Të lidhura me: ndërrim vajrash, lavazh, grasatim)
- j) Pajisje diagnostikimi për mjete të vogla dhe të rënda
- k) Torno

Per permbushjen e kesaj pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimeve dokumentacion provues si me poshte:

- 1- Fatura blerje/ fatura zhdoganimi/kontrata qeraje noteriale/ kontrate huaperdorje noteriale, si dhe Per permbushjen e ketij kriteri
- 2- Operatori ekonomik duhet te ngarkoje ne SPE fotot e pajisjeve te instaluar ne servis.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre pajisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit dhe mirëmbajtjes të kërkuara ne Shtojcën 7 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit).*

**Në rastet e bashkimit të operatorëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

➤ **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Specifikimet teknike dhe termat e references janë hartuar nga specialist i fushës, i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

*Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

## **Njësia e Prokurimit**